



Breaking News:

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, gjatë 24 orëve të fundit



16/04/2025

Lushnjë – Qëlloi Me Armë Gjahu, Pronarin E Ambientit Ku Shkoi Për Të Vjedhur Gjatë Natës, Identifikohet Dhe Kapet 65-Vjeçari

Lushnjë

Qëlloi me armë gjahu, pronarin e ambientit ku shkoi për të vjedhur gjatë natës, identifikohet dhe kapet 65-vjeçari.

Menjëherë pas kallëzimit të shtetasit F. M., 66 vjeç, se gjatë natës, sapo një shtetas kishte hyrë për të vjedhur në kasollen në pronësi të tij, ai e kishte konstatuar dhe gjatë konfliktit me të, autori i tentativës për vjedhje e kishte qëlluar me armë gjahu, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Lushnjë kanë organizuar punën për kapjen e autorit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe policore, u identifikua dhe u kap autori i dyshuar i rastit, shtetasi D. D., 65 vjeç.

I dëmtuari, shtetasi F. M., ka marrë asistencë mjekësore dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

◀ Drejtoria Vendore e Policisë Berat, gjatë 24 orëve të fundit

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Premtimi” ▶

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

▼

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)